REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar më; Primljeno:	04-06- 2021	
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
15-30-	30031	

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIK OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPSHTINA LIPLJAN
MUNICIPALITYOF LIPJAN

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika, nenit 16 ,17 c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit nr. 07/l-006 për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës , Ligji nr. 03/l-049 për Financat e Pushetit Lokal dhe nenit 20 paragrafi.1 i Statutit të Komunës së Lipjanit, 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 03.06.2021, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

VENDIM
PËR LIRIMIN NGA PAGESA E TAKSAVE KOMUNALE

Neni 1

LIROHEN , nga pagesa e taksave komunale për vitin 2021 duke përfshirë periodën kohore prej datës 01.01.2021 deri me datën 31.12.2021, shfrytëzuesit e hapësirave publike, si vijon:

1. Lirim nga pagesa e taksës komunale për hapësira publike , terasa dhe për shfrytëzimin e hapësirave publike për vendosjen e objekteve të përkohëshme për të gjithë shfrytëzuesit e hapësirave publike,
2. Lirim nga pagesa e taksës për shfrytëzimin e parkingjeve në pronësi të Komunës për të gjitha automjetet taksi të Komunës së Lipjanit.

Neni 2

Lirimi nga pagesa e taksave komunale bëhet me qëllim të krijimit të lehtësirave financiare për shfrytëzuesit e cekur edhe në këtë vit të përballjes me pandeminë COVID -19.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Shërbime Publike.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

15Nr. 30-30031

Lipjan, më 03. 06. 2021

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Dauf Azemi